

1 E hënë, 22 maj 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e Seancës, ju lutem thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar
11 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
12 Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Mirëmëngjes, të gjithëve.

15 Z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi janë të pranishëm në
16 sallën e gjyqit. Ndërkohë që z. Krasniqi vazhdon të na ndjekë
17 përmes videolidhjes.

18 Përpara sesa të fillojmë me seancën e sotme, Trupi
19 Gjykses dëshiron që të trajtojë një çështje organizimi që ka
20 të bëjë me provën materiale P90.

21 Znj. Sekretare, a mund të siguroj që kur caktohen numrat
22 e provave materiale që kanë të bëjnë me Dëshmitarin 3165, me
23 dëshminë e tij dhe provat materiale të lidhura që përmban P90
24 të merret parasysh rregulla 154 përpara deklaratës. Ndërkohë
25 që, për aq sa është e mundur, numrat e provave materiale do të

1 duhet që të ndjekin numrin e provave materiale të caktuar
2 dokumente të cilat janë paraqitur nga Prokuroria.

3 Ju lutem, a mund të na thotë numrin ERN të provës
4 materiale përkuese për procesverbal, ju lutem.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata e cila
6 aktualisht ka numrin P90 do të mbetet me këtë numër. Ndërkohë
7 që prova materiale të lidhura, të përmbajtura në të, pra,
8 domethënë, prova e parë është ERN U008-7583 dhe përkthimi
9 përkues në anglisht do të marrë numrin P90-01. Provat e
10 lidhura me ERN U0032253 dhe përkthimet në anglishte do të jenë
11 provë materiale P90.2. Ndërkohë që ERN U0087585 do të marrë
12 numrin e provës materiale P90.3. Ndërkohë që ERN U0032255 do
13 të bëhet provë materiale me numrin P90.4.

14 Këto janë të gjitha, të nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon
16 masave mbrojtëse që kanë të bëjnë me Dëshmitar 40355. Ju lutem
17 znj. Sekretare, mund të na çoni në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi tani në seancë publike.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që
12 po presim, dua që të kalojmë pak në seancë private në mënyrë
13 të tillë që të shpjegojmë disa prej kodeve që dëshiroj që të
14 përdor gjatë marrjes në pyetje [REDAKTUAR] dhe pastaj do të
15 kalojmë përsëri në seancë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Do qëndrojmë për pak çaste në seancë publike kur të vijë
18 dëshmitari dhe pastaj do kalojmë në seancë private për të bërë
19 shpjegimet që kërkuat.

20 [Dëshmitari vijon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
22 Dëshmitar. Më dëgjoni?

23 DËSHMITARI: Po. Mirëmëngjes.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
25 vazhdojmë me marrjen në pyetje nga avokati i z. Selimi.

1 Personi që do t'ju marrë në pyetje është z. Roberts i cili
2 është i ulur në mes të sallës.

3 Ju kërkoj që t'i jepni përgjigje pyetjeve thjesht me
4 përgjigje të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, ju
5 lutem na thoni dhe avokati do ta sqarojë pyetjen.

6 Gjithashtu, ju lutem kujtoni që të thoni se cila është
7 baza e njohurive, fakteve dhe rrethanave mbi bazën e të cilave
8 do të pyeteni.

9 Ju kujtoj se jeni nën detyrimin për të treguar të
10 vërtetën ashtu siç është deklaruar prej jush në deklaratën
11 solemne. Gjithashtu, ju lutem kujtohuni që të flisni përpara
12 mikrofonit dhe të prisni pesë sekonda përpara sesa të jepni
13 përgjigje në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

14 Nëse e keni të nevojshme që të merrni pushim, ju lutem na
15 thoni për të bërë organizimet e nevojshme.

16 Ju lutem, mos flisni më në qoftë se ju kërkoj që të mos
17 flisni më ose në qoftë se do shikoni që do të ngre dorën siç
18 kam bërë, për shembull, të enjten.

19 Z. Roberts, dëshironi që këtë pjesë ta organizojmë në
20 seancë publike apo jo?

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Nuk do të zgjasë më shumë sesa
22 disa minuta.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për mbrojtjen
24 e dëshmitarit dhe identitetit [REDAKTUAR] do të kalojmë në
25 seancë private.

1 Kështu që, znj. Sekretare, na kaloni në seancë private ju

2 lutem.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03165 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër z. Roberts

Faqe 7

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim]

23 PY. Pas pyetjeve të bëra nga avokati i z. Veseli të enjten e
24 shkuar, ju thatë ose i dhatë dëshmitë tuaja lidhur me dëmtimet
25 që i janë shkaktuar në fshatrat përreth nga forcat serbe. A e

1 mbani mend të keni dhënë shpjegime të kësaj natyre?

2 PË. Ndoshta i kam dhënë, po këto dëmtime janë bë pas
3 bombardimeve të NATO-s në vitin 1999.

4 PY. Po thua, pra, po flasim për fshatrat rreth e qark fshatit
5 tënd, jo fshatin tënd, po flasim për fshatrat përreth të cilat
6 përsuan shumë dëmtime djegie dhe vrasje. Bëhet fjalë për
7 ofensivën e verës së korrikut, gushtit dhe shtatorit 1998,
8 kështu?

9 PË. Në korrik, gusht, shtator 1998 nuk ka pasë dëmtime aq të
10 mëdhaja. Ka pasë aty-këtu pak, po nuk ka pasë dëmtime në
11 territor tonin, domethënë, jo veç në fshat tem, po dhe në
12 rreth tonin.

13 PY. Pavarësisht raporteve ushtarake që t'u treguan javën që
14 shkoi, ti vazhdon që të thuash që ka pasur pak dëmtim apo pak
15 shkatërrim në këto fshatra ose në fshatrat rreth e qark
16 fshatit tuaj në gusht dhe në shtator të vitit 1998, kështu,
17 për të qenë të qartë?

18 PË. Po.

19 PY. A ke udhëtuar përreth këtyre fshatrave, domethënë, për të
20 parë se cila ishte situata, a e ke parë me sytë tuaj situatën
21 në këto fshatrat përreth?

22 PË. Po.

23 PY. Kur ke udhëtuar përreth gjatë asaj periudhe, se kam
24 përshtypjen që ke thënë gjatë marrjes në pyetje nga Prokuroria
25 që kryesisht ke qëndruar në fshatin tënd, domethënë, në gusht,

1 në shtator të vitit 1998.

2 PË. [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 PË. Nuk më kujtohet.

8 PY. A ke parë refugjatë në atë zonë, rreth e qark, të cilët
9 ishin të detyruar të largoheshin?

10 PË. Po, ka pasë [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR] ata nuk janë kthy napër shtëpia.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të
15 kalojmë në seancë private, ju lutem, për një çast?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 Kalojmë në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë të hapur.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, lidhur me pozicionin D, na the javën e shkuar
24 që ka pasur vrasje dhe djegie. A të kujtohet kjo?

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj. Kam përshtypjen që

1 atij iu lexuan raportet rreth zonave përreth, por nuk është se
2 tha dëshmitari në mënyrë të shprehur që ka parë gjëra të tilla
3 në zonën përreth.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Kjo ju
5 lutem sqaroheni sesi e mësoi këtë gjë dëshmitari.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim]

7 PY. Z. Dëshmitar, si mësove ti që kishte pasur djegie dhe
8 vrasje në zonën përreth?

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe për Prokurorinë është
10 transkripti me numër reference 4380.

11 DËSHMITARI: [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR] Në

17 atë kohë në korrik, gusht, nuk ka pasë kallje rreth tonit. Nuk
18 ka pasë kallje masive, domethënë, të fshatra.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 Z. ROBERTS: [Përkthim]

23 PY. Dhatë dëshmi javën që shkoi që u kyçët në UÇK në fund të
24 korrikut 1998 dhe më pas ke qenë ushtar në fshatin tuaj deri
25 në fund të shtatorit 1998. A të kujtohet ta kesh thënë këtë

1 gjë?

2 PË. Po.

3 PY. Pas përfundimit të shtatorit, ti nuk ishe më ushtar për
4 një muaj dhe pastaj u ktheve përsëri si ushtar në fund të
5 tetorit, fillimin e nëntorit, kështu ka qenë?

6 PË. Po.

7 PY. A të duhej ty ndonjë leje ose autorizim që të largoheshe
8 nga vendi ku shërbeje?

9 PË. Po aty jena dalë veç roje të fshatit, çka jena tu bë
10 ushtria, me ndërrime e kemi pas dhe jena shku napër shtëpia. E
11 kam kry ndërrimin edhe jam shku, kur e kam kry ndërrimin, jam
12 shku në familje, në shtëpi.

13 PY. Për muajin tetor 1998 kur nuk ishe më ushtar i UÇK-së,
14 këtë e vendose vetë me dëshirën tënde. Nuk është se të duhej
15 autorizimi i ndonjë personi që të mos ishe më pjesëtar i UÇK-
16 së, kështu?

17 PË. Në tetor mbasi më ka ndodhë rasti është duht me nejt në
18 familja për ngushëllime që a kanë gjindja. Dhe ke na a kanë
19 zakon që janë ardhë një kohë të gjatë për ngushëllime, afër
20 një muaj ditë kam nejt unë, gati për ditë, kam nejtun në
21 familje tuj prit gjind.

22 PY. Më pas kur u rikyçe, u rikyçe në atë momentin që ishte më
23 i përshtatshmi sipas mendimit tënd, kështu?

24 PË. Jo. U kyça kur u ndërpre pamja. U mbyll pamja, atëherë më
25 erdhën dhe prapë më thanë që "Je i lirë për me ardhë me u kyç,

1 që do me u kyçun në mbrojtje të fshatit me ushtarë të fshatit
2 me bë roje në fshat".

3 PY. Kjo ka qenë në nëntor, pasi nuk ishe më ushtar i UÇK-së
4 për një muaj më përpara, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Po njerëz të tjerë nga ju që bënit roje në fshatin tuaj,
7 a u ç'kyçën nga UÇK-ja dhe pastaj u ribashkuan përsëri me UÇK-
8 në më vonë?

9 PË. Po ashtu ka qenë edhe me këta. Nuk janë shkyç një muaj
10 ditë, po kur pas ofensivës janë shku napër shtëpi njëherë deri
11 kun janë tubu prapë. Po tash nuk e di me data.

12 PY. A ka pasë ndonjë persona nga jashtë fshatit tuaj që ka
13 ardhur në fillim të marsit, mars, prillit 1998, që erdhi për
14 të mbrojtur fshatin tuaj, domethënë, dikush nga jashtë fshatit
15 që erdhi për të mbrojtur fshatin tuaj në mars apo prill 1998?

16 PË. Nuk më kujtohet. Nuk e di.

17 PY. A jeni në dijeni të ndonjë personi që u ç'kyç nga UÇK-ja
18 gjatë asaj periudhe që u ç'kyçët dhe juve, megjithëse ju u
19 ç'kyçët për një muaj, a ka pasur persona që kanë qëndruar
20 jashtë UÇK-së ose janë ç'kyçur nga UÇK-ja për periudha më të
21 gjata sesa një muaj?

22 PË. Nuk e di.

23 PY. A kishte pasoja në qoftë se një pjesëtar i UÇK-së
24 largohej ose dëshironte që të largohej dhe thjesht dorëzonte
25 armën dhe nuk luftonte më, kishte pasoja për këtë person?

1 PË. Nuk muj me u përgjigj. Nuk e di.

2 PY. Ti ke dhënë dëshmi që personi nga i cili ke marrë armën
3 ishte shumë i lodhur për të vazhduar për të vazhduar për të
4 luftuar, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe nuk është se kishte ndonjë pasojë për këtë person për
7 faktin që ishte shkëput nga UÇK-ja, kështu?

8 PË. Nuk e di. A ka pasë a jo, nuk e di.

9 PY. A u rikyçën apo a u kyçën përsëri në UÇK këta persona
10 pasi ju dhanë juve armën? A është kjo çfarë na ke thënë në
11 dëshminë më përpara?

12 PË. Më duket. Më duket se është kyç prapë. Po s'jam i sigurtë
13 kur.

14 PY. Në rregull. Në qoftë se iu rikyç kjo provon që nuk kishte
15 pasoja që dikush, për shembull, vendoste që të ç'kyçej nga
16 UÇK-ja për një periudhë dhe pastaj pas një periudhe vendoste
17 që të kyçej përsëri, kështu?

18 PË. Nuk e di. Ndoshta dhe ka pasë leje. Nuk muj me të thënë
19 kurrgjë për atë persona ose për atë punë. Ndoshta dhe ka pasë
20 ndonjë leje, po unë nuk e di.

21 PY. Por në njësitin tuaj dhe në UÇK, me çfarë keni kuptuar
22 juve, domethënë, në njësitin tuaj dhe pjesëmarrja në njësitin
23 tuaj dhe në UÇK ishte tërësisht vullnetare, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Ju dëshmuat që duhet të siguronit vetë uniformën dhe që e

1 keni pagu vetë uniformën gjatë kohës që keni qenë ushtar,
2 kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe nuk keni marrë asnjë pagesë për shërbimin që keni
5 kryer dhe që mund të largoheshit në çdo pikë që ju e shikonit
6 të përshtatshme për t'u larguar kështu?

7 PË. Nuk e kam marrë asnjë pagesë. Edhe kur është ardhë lajmi
8 me u tërhek, nuk jam tërhek veç unë, po jena tërhek të gjithë
9 çka kena qenë aty. Nuk jam tërhek vetëm unë si individ, po të
10 gjithë kush jena, kenë qenë aty na ardhë lajmi me u tërhek.

11 PY. Por si individ, si ushtar individ i UÇK-së, ti mund të
12 largoheshe nga UÇK-ja në çdo pikë që vendosje ti dhe nuk do të
13 kishte pasoja mbi ty, domethënë, ishte një zgjedhje personale,
14 ishte një zgjedhje vullnetare, domethënë, ju mund të bëheshit
15 pjesëtar i UÇK-së kur donit dhe mund të largoheshit kur donit,
16 kështu?

17 PË. Nuk ma merr mendja që ka qenë bash kështu, se me u largu
18 unë pa kurrgjë, nuk ka kanë e mirë dhe nuk ka kanë e ndershme
19 me u largu unë. Unë për vete nuk muj me të thënë, nuk muj me
20 të dhënë përgjigje në këtë punë. Unë nuk jam largu unë. Tash
21 për tjerët nuk muj, nuk di çka kanë ba.

22 PY. Lidhur me marrëdhënien tuaj me komandantin e UÇK-së në
23 fshatin tuaj ose udhëheqësin e UÇK-së në fshatin tuaj, a ju
24 kujtohet të keni folur lidhur me marrëveshjen që e përmendëm
25 pak më përpara?

1 PË. Jo, unë nuk kam qenë aty kur është bërë marrëveshja. Nuk
2 kam qenë në atë tubim unë. Nuk më kujtohet që kam qenë në atë
3 tubim.

4 PY. Por ti na the gjatë dëshmisë javën që shkoi që komandanti
5 lokal i UÇK-së kishte organizuar takimin që çoi në këtë
6 marrëveshje, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe kjo leje ose ky miratim ishte shumë i rëndësishëm për
9 ju, apo jo, ose për fshatarët që morën pjesë në atë takim?

10 PË. Po kjo kur fshatarët i kanë tubu dhe i kanë, ju kanë
11 dhënë këtë të drejtë, unë nuk kam çka të diskutoj atë. S'un e
12 anuloj, as s'un e propozoj. Domethënë, ajo ka ndodhun. Janë
13 tubu fshatarët, janë tubu ushtria, i kanë thënë do të shkoni
14 edhe kaq edhe janë shku.

15 PY. Por me sa di ti, komandanti në fshatin tënd nuk kishte
16 nevojë për miratimin e ndokujt tjetër në mënyrë që të jepte
17 leje për këtë marrëveshje, kështu?

18 PË. Nuk e di. A ka bërë pyetje na i kënd a jo, nuk e di.

19 PY. Ju nuk e dini në qoftë se ai duhej që ta raportonte këtë
20 dikujt tjetër apo në qoftë se duhej të kërkonte ndonjë
21 autorizim lidhur me një marrëveshje që, në fakt, ishte shumë e
22 rëndësishme?

23 PË. Nuk e di. Nuk e di këtë punë.

24 PY. Duke marrë parasysh dëmet, shkatërrimet, vrasjet që u
25 përmendën lidhur me pozicionin D edhe pse - sipas dëshmisë

1 tuaj, nuk është se ishin shumë të pranishme - në fshatrat
2 lokalë, a është e pranueshme të thuhet që kishte një inat
3 potencial të mundshëm ndërmjet fshatrave lidhur me këtë
4 marrëveshje?

5 PË. Nuk e di.

6 PY. Ose në qoftë se nuk kishte ndonjë inat a kishte ndonjë
7 lloj xhelozie për shkak të faktit që marrëveshja donte të
8 thoshte që fshati juaj nuk do të kishte të njëjtin fat si
9 fshatrat e tjerë?

10 PË. Nuk e di.

11 PY. Në vizitën tuaj, në vizitat që keni bërë në diskutimet në
12 fshatrat e tjerë kur shkove që t'i vizitoje, a e biseduat
13 ndonjëherë, a doli ndonjëherë kjo gjë si temë?

14 PË. Jo.

15 PY. Po vetë marrëveshja nuk ishte sekret, apo jo? Besoj se na
16 the që ishin me qindra bashkëfshatarë që kishin rënë dakord që
17 delegacioni të merrte pjesë në këto bisedime që rezultuan në
18 këtë marrëveshje, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Thua që ka mundësi që disa nga fshatrat rreth e rrotull
21 të kenë ditur që ekzistonte kjo marrëveshje, apo jo?

22 PË. Besoj që e kanë ditë.

23 PY. Më konkretisht dëshmove, për reagimin e personit numër 4,
24 por nuk e di nëse ishte në favor apo kundër marrëveshjes dhe
25 as nuk mund të na thuash në qoftë se ishte i mërzitur për këtë

1 marrëveshje. Mban mend që fole për këtë javën e kaluar?

2 PË. Po këto, unë nuk i kam dëgju, po e ka cekë numri 4 që do
3 ja bëj një të keqe këtij fshatit.

4 PY. Po personi numër 4 nuk e zë në gojë fare marrëveshjen apo
5 jo, në deklaratën tuaj, sipas asaj që thoni ju?

6 PË. Po nuk e kam dëgju unë.

7 PY. Pra, ti nuk e di nëse mërzitja e tij apo zemërimi i tij
8 ka ndonjë farë lidhje me marrëveshjen, apo jo?

9 PË. Nuk e di.

10 PY. Kalojmë tani tek tema e dytë. Jemi në seancë të hapur,
11 bëni kujdes ju lutem me emrat dhe me vendet dhe përpiqu të
12 përdorësh kodet. Kjo ka lidhje me ditën konkrete ku personi
13 numër 1 u kidnapua.

14 Të jemi të qartë, do të flasim edhe më vonë, ne nuk po e
15 vëmë në dyshim që kanë ardhë burra të maskuar, kanë hyrë në
16 fshat dhe e kanë kidnapuar personin numër 1. Jemi të qartë ne
17 për këtë. Ne thjesht duam të sqarojmë se çfarë dëshmie ke
18 dhënë ti lidhur me këtë ngjarje.

19 Pikë së pari, the që të gjithë këta burrat ishin me
20 maska. Kishin maska të plota që u mbulonin komplet, komplet
21 fytyrën dhe ju dukeshin vetëm sytë?

22 PË. Po edhe goja.

23 PY. Pra, kishim marrë masa ekstreme që të mos i njihnit, apo
24 jo, jo vetëm ti por edhe të tjerët në fshat?

25 PË. Sigurisht.

1 PY. Edhe pse ishe pak metra larg tyre - dhe më duket se në
2 dëshmi the që e kape një prej tyre - ti s'mund ta identifikojë
3 se maskat ishin kaq të plota sa që nuk u dalloje dot tiparet,
4 apo jo?

5 PË. Nuk kam mujt me dallu.

6 PY. Edhe the se kishin uniforma të zeza. Dua të jem i qartë
7 nëse e kam kuptuar siç duhet. Uniformat nuk ishin identike,
8 apo jo? Ishin thjesht tesha të zeza. Këtë deshe të thojë?

9 PË. Tesha të -- me uniforma të zeza, po.

10 PY. Po ishin identike këto teshat apo ishin thjesht tesha të
11 zeza një me xhaketë të zezë, një me pulovër të zezë, një me
12 pantallona të zeza?

13 PË. Ishin identike. Shka kam pa unë identike, domethënë,
14 tashti nuk e di. Nuk e di çka, qysh i kanë pasë. Shembull
15 shoferin s'e kam unë. Qëta ça i kam pa unë, i kanë pasë
16 identike.

17 PY. Dhe këto uniformat identike mund të bliheshin thjesht ose
18 mund të qepeshin thjesht, sepse thjesht tesha të zeza ishin,
19 uniforma të zeza, apo jo?

20 PË. Nuk e di ku i kanë marrë.

21 PY. Dhe nuk e di në qoftë se ata ishin thjesht ishin anëtarë
22 të policisë ushtarake thjesht sepse kishin veshur këto
23 uniforma, apo jo?

24 PË. Po. Edhe ata i bëjshin. Policia ushtarake bëjshin kesi
25 uniforma të zeza, domethënë, të njëjta gati, identike kanë

- 1 qenë, veç që këta kanë qenë dhe në emblemë të UÇK-së atë ditë,
2 PY. Dhe dëshmi kur ju pyeti Mbrojtja e z. Thaçi për emblemën,
3 nuk do t'i hyj në hollësi kësaj pjese. Po sa i takon
4 uniformave konkrete, duke pasur parasysh faktin që thjesht
5 ishin disa uniforma të zeza, ti nuk mund të thuash që ata
6 ishin individë apo persona të policisë ushtarake sepse mbanin
7 këto uniformat e zeza, nuk mund ta thuash me siguri, apo jo?
8 PË. Po, nuk muj me ditë tashti a kanë qenë policë ushtarakë
9 me uniforma apo kanë qenë ushtarë nuk e di unë. Unë i kam pa
10 me tesha të zeza dhe me emblemë të UÇK-së edhe me maska. Unë
11 tash nuk e di çfarë pozicioni kanë pasë aty.
12 PY. Në thelb ti e pranon që mund të kishte qenë kushdo me një
13 uniformë të zezë?
14 PË. Jo, kushdo nuk ka mujt me kanë ashtu.
15 PY. Po ashtu dhatë dëshmi se nuk ishit tek pozicioni A kur
16 arritën burrat e armatosur, e maskuar - më falni - dhe nuk i
17 ke dëgjuar asnjëherë këta burra të thonin që duam të flasim me
18 personin 6, kështu?
19 PË. Unë s'i kam dëgju. S'kam qenë aty.
20 PY. Pra, ti nuk e di me siguri pse donin të flisnin këta
21 burrat e maskuar me personin 6, apo jo?
22 PË. Jo, nuk e di.
23 PY. Ti nuk e di nëse kërkuan të shihnin ndonjë person tjetër
24 veç personit 6, kështu?
25 PË. Po këta e kanë kërkua personin 6 dhe nuk e kanë lënë me

1 dalë, domethënë, nuk muj me -- nuk e di më anejna pse e kanë
2 kërku atë ose pse e kanë marrë numrin 1. Nuk muj me ditë unë
3 këto. Po numrin 1 nuk e kanë leju dhe numri 1 është, për me
4 zbutë gjendjen, me zbutë situatën, ju ka thanë që "Hajt
5 shkojmë këtë anë. Dhe unë do t'ju bi numrin 6 dhe bisedojmë në
6 odë. Edhe nuk a problem çka do që kërkonit ju japim, i sqarojmë
7 aty".

8 PY. Edhe njëherë. Ti s'ishe i pranishëm vetë atje fizikisht
9 kur u bë ky muhabet.

10 PË. Jo.

11 PY. Ti vajte më pas?

12 PË. Jo.

13 PY. Informacioni që more lidhur me këtë bisedë të erdhi nga
14 bisedat që pate më pas me personin 2, 3 dhe bashkëfshatarët e
15 tjerë, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. A diskutove apo a ke diskutuar gjatë 20 viteve të fundit
18 me bashkëfshatarë të tjerë dhe me personat 2 dhe 3 rregullisht
19 lidhur me këtë ngjarje?

20 PË. Po, kena bisedu. Kena bisedu gjatë numrit 1 pse u
21 ekzekutu. Nuk kena bisedu unë pse janë shku, a pse i ka çu
22 fshati. Me këto tema nuk kena bisedu. Po veç rreth vrasjen
23 kena bisedu.

24 PY. Po duhet ta kenë diskutuar vazhdimisht çfarë ndodhi para
25 se të shkoje ti atje dhe se çfarë të tregoi 2 dhe 3 lidhur me

1 ato që kishin parë vetë dhe që kishin dëgjuar, kështu?

2 PË. Si the dhe një herë? Ka mundësi?

3 PY. Patjetër. Po duhet ta kesh diskutuar vazhdimisht çfarë
4 ndodhi para se të shkoje ti vetë te pozicioni A me personin 2
5 dhe 3, pra, me këta duhet ta kesh diskutuar vazhdimisht çfarë
6 ndodhi para se të shkoje ti vetë në pozicionin A, kështu?

7 PË. Po, kena. Këtë temë e kena disku, domethënë, si ka ndodhë
8 rasti. Qysh ka ndodhë. Qysh e kanë marrë. Veç qëto kena
9 diskutu. Kena, mbas vrasjes kena diskutu, se para vrasjes
10 s'kam mujt me diskutu unë.

11 PY. E kuptoj qartë. E ke diskutuar shpesh qysh kur ndodhi kjo
12 ngjarja me personin 2 dhe 3 dhe me bashkëfshatarët e tjerë që
13 ishin aty në atë kohë.

14 PË. Po.

15 PY. Unë jam kurioz nëse është e mundur ose nëse ti e pranon
16 se nuk mund të thuash konkretisht se çfarë ka ndodhur atë ditë
17 kur i krahason me atë që të është treguar më vonë sepse kanë
18 kaluar 20 vjet. Pra, a e pranon që është e mundshme që nuk e
19 bëni dot një ndarje të qartë lidhur me atë që di vetë ti
20 konkretisht dhe atë që të kanë treguar?

21 PË. Nuk muj me t'u përgjigj. S'di si ta shpjegoj këtë.

22 PY. Kërkoj ndjesë për mikrofonin.

23 Sa i takon kidnapimit. Ti e di që burrat e maskuar që
24 morën numrin 1 e morën nga fshati, po nuk e di me siguri nëse
25 janë të njëjtët persona përgjegjës për vrasjen e këtij personi

1 se nuk ke qenë i pranishëm kur ka ndodhur, kështu?

2 PË. Gjindja me maska kanë marrë numrin 1, 2 dhe 3. 2 dhe 3 i
3 kanë zbrit edhe kanë vazhdu rrugën. Edhe unë mbas tyne jam
4 nisë në at një gjindjen që e kanë bë vrasjen.

5 PY. Që të jemi të qartë. Se pikërisht këtu doja të dilja, ti
6 nuk e di 100 për qind, s'mund të jesh i sigurtë, se kjo
7 gjindja që mori personin 1 janë të njëjtët që e kanë vrarë se
8 ti nuk ke qenë atje kur ka ndodhur, kështu?

9 PË. Po, nuk kam qenë unë. Prezent s'kam qenë. Unë s'kam qenë
10 prezent.

11 PY. Megjithëse ndonjëherë mund të jetë e dukshme, por në të
12 njëjtën kohë, ti nuk mund ta dish me siguri dhe ti nuk mund ta
13 dish, nuk mund të thuash që fleta u vendos nga të njëjtët
14 persona që kidnapuan numrin 1, kështu?

15 PË. Unë kur kam shku e kam gjet të vramë edhe letrën e kam
16 gjet aty. Nuk muj me të thënë kurr gjë.

17 PY. E kuptova. Por nuk e di me siguri, domethënë, ti e di që
18 këto kanë ndodhur, ama nuk e di 100 për qind që burrat e
19 maskuar ishin përgjegjës për të dyja këto gjëra.

20 PË. Mu ma merr mendja se pas atyne tjerë nuk ka pasë. Vetë
21 s'kam qenë prezent, por përpos tyne, nuk besoj që ka pasë të
22 tjerë.

23 PY. Në rregull.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani më duhet
25 të kaloj në seancë private për pyetjet e radhës, u përpoqa të

1 bëja sa më shumë pyetje në seancë publike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Sekretare, na kaloni ju lutem në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03165 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03165 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 27

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03165 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 28

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03165 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 29

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
6 të nderuar Gjykatës.

7 Pyetje të palës tjetër Znj. Alagendra:

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje. Mund të ketë disa
10 mbivendosje në data dhe deklarata që keni dhënë më përpara,
11 megjithatë do t'i marrim njëra pas tjetrës.

12 Ju thatë që u kyçët në UÇK më 24 korrik 1998. E saktë,
13 kështu është?

14 PË. Po.

15 PY. Kjo ndodhi sepse erdhi një ushtar në orën 2.00 të
16 mëngjesit që kërkonte përforcime, kështu jeni kyçur në UÇK, a
17 është e saktë kjo?

18 PË. Po.

19 PY. Dëshmuat se nëse nuk kishit armë, këtë thatë më datë 18
20 maj, pra, në qoftë se nuk kishit armë dhe në qoftë se nuk do
21 të kyçeshit në UÇK, nuk do ju duhej që të përgatisnit ose të
22 qepnit një uniformë, a të kujtohet kjo?

23 PË. Po.

24 PY. Kur e bëre uniformën?

25 PË. Uniformën e kam bë unë, nuk më kujtohet data saktë, ma

1 herët

2 PY. Përpara datës 24 korrik apo pas kësaj date?

3 PË. Para. Po nuk e di saktë sa ditë.

4 PY. Pra, përpara datës 24 korrik, kështu?

5 PË. Po. Nuk e di datën e saktë një ditë, dy ndoshta. E jam
6 përgatit, jam kanë veç tu pritë me thirrur. Po nuk mujt me
7 ditë në datë.

8 PY. Në rregull. Po ti e konfirmon që uniformën e bërë gati
9 përpara sesa të kyçeshe në UÇK, kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Në kohën që përgatite uniformën, po armën e kishe?

12 PË. Po.

13 PY. A jeni në dijeni në qoftë se dhe persona të tjerë kishin
14 edhe uniformë edhe armë përpara sesa të kyçeshin në UÇK?

15 PË. Nuk e di.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoj
17 që të kalojmë në seancë private.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për mbrojtjen
19 e dëshmitarit dhe identitetit të tij, le të kalojmë në seancë
20 private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W03165 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagenda

Faqe 35

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,
7 të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 vazhdoni.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

11 PY. Të enjten ti përmende një ankesë që ke bërë më datë 22
12 shkurt të vitit 2000, ja the këtë avokatit të z. Thaçi. A të
13 kujtohet ky dokument? Është dokumenti me numër identifikimi
14 SPOE0067703. Ndërkohë që versioni në shqip është dokumenti
15 SITF0031587.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në
17 seancë publike por prova materiale nuk duhet të tregohet në
18 publik. Thjesht për të qenë e sigurtë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Na thotë Sekretaria që kështu do të jetë, pra, nuk do të
21 tregohet në publik prova.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

23 PY. Kur ju tregua ky dokument, ju thatë që nuk ju kujtohej se
24 sa ka qenë data saktësisht kur e keni bërë këtë ankesë, kështu
25 ka qenë?

1 PË. Nuk më kujtohet data saktë.

2 PY. Në rregull. Thjesht dua që të konfirmoj. Kjo është një
3 ankesë që e ke bërë ti personalisht, apo jo?

4 PË. Sigurisht, mund me kanë.

5 PY. Në këtë ankesë, ju thoni që numri 1 është marrë nga UÇK-
6 ja nga shtëpia e tij, kështu është? Këtë thoni në këtë
7 dokument, apo jo?

8 PË. Po këtu thoj, po këtu ka mujt me bë gabim përkthyesi se
9 nuk është e vërtetë që është marrë në shtëpi, po ndoshta
10 ndonjë gabim ka mujt me ndodhë te përkthimi.

11 PY. Në rregull. Pra, e konfirmoni që ai nuk është marrë nga
12 shtëpia, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. A mund të jetë e saktë që ju nuk i keni parë personat me
15 maska që e kanë marrë numrin 1? Po ju kanë thënë fshatarët që
16 kanë qenë personat me maska që kanë marrë numrin 1?

17 PË. Unë i ka pa do, i kam pa me maska, po nuk i kam pa të
18 gjithë.

19 PY. Sa vetë keni parë me maska?

20 PË. Nuk më kujtohet dy, tre i kam pa unë. Po tash nuk jam i
21 sigurtë janë ka dy a tre.

22 PY. Keni dhënë shumë dëshmi ku keni thënë që keni parë katër
23 veta me maska. A ju kujtohet kjo?

24 PË. Po, ndoshta. Nuk e di tashti unë sa ka pasë aty, po unë
25 me dy jam ballafaqu ma shumë tashti. Ka pasë ndoshta edhe

1 tjerë tuj shku mbrapa, po nuk jam i sigurtë me i cekë me numra
2 të saktë.

3 PY. Në rregull. Dhe më herët sot konfirmuat që nuk keni qenë
4 i pranishëm kur ka ndodhur vrasja [REDAKTUAR]? Nuk e keni parë
5 me sytë tuaj këtë gjë? Numrin 1.

6 PË. Jo, në vrasje nuk kam qenë.

7 PY. Pajtoheni me mua, Dëshmitar, që ju nuk identifikoni
8 konkretisht ndonjë individ si personi i cili e ka marrë numrin
9 1 apo që e ka vrarë atë, është kështu apo jo?

10 PË. Nuk muj me ditë saktë me emër.

11 PY. Pra, lidhur me identifikimin e tyre nuk është se keni
12 identifikuar një person konkret që e ka bërë këtë gjë, kështu?

13 PË. Jo.

14 PY. Në rregull. Tani i kthehem dhe një herë kësaj ankese.
15 Ajo çfarë thuhet këtu është që ju i keni parë të dyshuarit pa
16 maska, kjo nuk është e saktë apo jo?

17 PË. Edhe një herë a ka mundësi pyetjen?

18 PY. Në ankesën që keni bërë thoni që i keni parë të dyshuarit
19 pa maskë, pa maska, a është e saktë kjo?

20 PË. Unë nuk e kam thënë këtë dëshmi. Po këto ka mujt me i
21 thënë tjetërkush. Unë s'e kam thënë që e kam pa të maskumit pa
22 maskë.

23 PY. A po shihni dokumentin që përmenda pak më herët,
24 Dëshmitar?

25 PË. Po. Këta tjerët po dy. Po.

1 PY. Gabim është kjo?

2 PË. Jo, jo nuk është gabim. 14 dhe 15 i kam pa po. Se s'i
3 lexova deri në fund. Me numra si ma dha këto.

4 PY. Pra, ke parë 14 dhe 15?

5 PË. Po.

6 PY. Jo 4? Kështu?

7 PË. 4 e kam pa tuj shku. Këta i kam pa pas vrasjes.

8 PY. Po. Pra, mbështetur në ankesën që ke bërë, Dëshmitar, a
9 thua që ke parë dy nga të dyshuarit që nuk kishin maska,
10 kështu?

11 PË. Nuk janë të dyshum këta. Po këta janë dalë. Kanë dëgju
12 krisma. Nuk janë të dyshun. I ngjoh personalisht të dy. Nuk
13 janë këta të dyshum. Po janë dalë kur i kanë dëgju krismat,
14 vrasjen kur e kanë dëgjuar dhe këta janë dalë. I ngjohë të
15 dytë, domethënë, nuk janë të dyshum këta dy persona.

16 PY. Atëherë le të përqendrohemi pak në atë çfarë thuhet në
17 këtë dokument që është ankesa juaj e parë. Këtu thuhet:

18 "Që pas rastit, pas incidentit kam parë dy të dyshuar pa
19 maska..."

20 Thjesht dua të konfirmoj që nuk keni parë asnjëherë të
21 dyshuarit pa maska më pas, sepse ti nuk e di kush janë të
22 dyshuarit apo jo?

23 PË. Nuk i di kush janë të dyshuarit.

24 PY. Pra, ajo çfarë ke thënë në këtë dokument nuk është e
25 saktë, kështu?

1 PË. Po ndoshta dhe përkthimi nuk ka mujt me kanë, se dhe
2 përkthimi nuk është i saktë.

3 PY. Në rregull. Më 22 janar 2003, ke dhënë një dëshmi.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe për referencë dokumenti
5 është U008-P90, domethënë, është prova materiale P90 dhe faqja
6 konkrete është [REDAKTUAR]. Shohim
7 paragrafin e tretë në versionin në shqip.

8 PY. Në këtë intervistë, në këtë dëshmi që keni dhënë, z.
9 Dëshmitar, keni përmendur emrat e personave që ju dyshoni që
10 të kenë qenë ekzekutuesit, kështu?

11 PË. Po, kam përmend dy persona që i kam pa. Ndoshta këto
12 tjerët janë që më kanë thënë mbasandej. Po dy i kam, atë ditë
13 që i kam taku une tuj e çu [REDAKTUAR], ata i kam pa
14 personalisht vetë, 12 dhe 13.

15 PY. I ke parë pa maska?

16 PË. Po.

17 PY. Po këtë nuk e thoni këtu, apo jo?

18 PË. Po ndoshta s'më kanë bë pyetje. Ku me dit. Mvaret pyetjen
19 çfarë ma kanë bë. Nuk e di. Mvaret ça më kanë pyet atje.

20 PY. Në rregull. Ajo çfarë thoni në këtë dokument është që
21 "Unë dyshoj kryesisht" të dy personat që janë me emër këtu që
22 janë të dyshuarit për vrasjen kështu? Për vrasjen e numrit 1,
23 kështu?

24 PË. Po tashti për vrasjen e numrin 1, unë të kallëzoj ça i
25 kam pa maska. Tashti përkthimi qysh është bë nuk muj me ditë

1 unë. Unë qita që i kam pa pa maska, po t'i kallëzoj, 12, 13,
2 4, dhe 5. Këta i ka pa, domethënë, gjatë rrugës edhe 14 dhe 15
3 që kanë dalë pas vrasjes. Këta i kam pa para vrasjes, këta dy
4 i kam pa pas vrasjes.

5 PY. Nuk i ke parë ti ata atëherë, kështu?

6 PË. Unë i kam parë 4, 5, 12, 13, [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 PY. Hera e parë që përmendni 12 dhe 13 është në vitin 2003
10 kur keni dhënë këtë deklaratë, kështu?

11 PË. Po këta i kam pa fillimit, tash nuk e di saktë kur e kam
12 dhënë deklaratën e kur më kanë pyet. I ke parë prej fillimit,
13 por nuk i ke përmend deri në vitin 2003, kështu? Thjesht për
14 t'ju kujtuar që jemi në seancë të hapur, ju lutem përmendni
15 numrat, z. Dëshmitar.

16 PË. 12 dhe 13 i kam tuj shku tuj e çu 1 te A. Tuj çu 1 te A
17 këta i kam pa në rrugë përballë me A. Të ndalun.

18 PY. Në rregull. [REDAKTUAR]

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Është paragrafi i parë në
20 versionin anglishte.

21 PY. Këtu thuhet:

22 "Më vonë dëgjova ca fjalë, disa thashetheme, që numri 14
23 kishte dëgjuar diku për njerëzit që kishin vrarë numrin 1, por
24 nuk e kam kontaktuar atë për këtë gjë".

25 A të kujtohet ta kesh thënë këtë gjë?

1 PË. Po, e kam kontaktun në numrin 14, është dalë, domethënë,
2 pas vrasjes, po më tha që "nuk i kam pa". Edhe 15 janë ka
3 bashkë, kur janë dalë prej malit.

4 PY. Po nuk thuhet kështu këtu. Ajo çfarë thuhet në këtë
5 dokument, Dëshmitar, është që ke dëgjuar thashetheme që numri
6 14 kishte dëgjuar diku për njerëzit që kishin vrarë numrin 1.
7 Por thua që "nuk e kam kontaktuar atë për këtë". Kjo është
8 pyetja ime për ju. Pra, a ke kontaktuar me këtë persona më
9 vonë pasi kishe dëgjuar këto thashetheme?

10 PË. Jo, ma vonë nuk kam ka dëgju. Po këtë e kam pa
11 personalisht vetë. Po mund me kanë edhe përkthimi mund me
12 kanë, mos me ka i saktë.

13 PY. Në rregull. Pra, nuk e keni kontaktun numrin 14 më pas për
14 të pyetur se kush e dinte apo kush mund të kishte ditur se
15 kush ishte përfshirë në vrasjen. Është një vlerësim, është një
16 përmbledhje e saktë kjo?

17 PË. Jo, nuk e kam taku. Veç atë ditë, veç aty te kufoma që ka
18 dalë, te vrasja. Përpos atë ditë e kam aty dhe më jo. Atë ditë
19 i kam bë në pyetje. Tha "Nuk kam njohuri. I ndjeva krismat
20 dola". Dhe më s'e kam kontaktun. S'ëm kujtohet që e kam
21 kontaktun.

22 PY. Ai s'të ka thënë asnjëherë vetë ty që kishte dëgjuar për
23 personat që e kishin vrarë numrin 1? Nuk ta ka thënë asnjëherë
24 një gjë të tillë apo jo?

25 PË. Ai i ka ndëgju krismat dhe ka dalë me këqyrë shka është

1 bërë. Nuk më ka thënë kështu. Po ai është dali pej malit, kur
2 kanë dëgju krismat është dalë në rrugë te krismat ku kanë. Dhe
3 aty unë kam qenë kur kanë ardhun këta dhe i ka pa të vramë.

4 PY. Po. Kjo është pjesa e parë. Por, po flas për pjesën e
5 fundit të kësaj fjalie. Vetëm pjesën e fundit të kësaj fjalie
6 që ke dhënë në dëshminë tuaj. Të lutem, lexoje edhe njëherë?

7 PË. Cilin paragraf unë këtu? Ose me i lexu rend?

8 PY. Paragrafi i parë fare në fillim të faqes, dy rreshtat e
9 fundit, të lutem.

10 PY. Nuk e kam thënë unë këtë. Nuk më kujtohet kjo.

11 PY. Në rregull.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Le të shohim një tjetër
13 dokument SPOE0006.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, një
15 çast sepse është ndërpretë transkripti.

16 Z. Dëshmitar, do bëjmë një pauzë për disa çaste.

17 DËSHMITARI: A bën të dalë jashtë për dy minuta edhe
18 kthehna?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
20 dalësh.

21 Znj. Asistente, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin nga
22 salla. Ju lutem mos flisni me asnjë lidhur me dëshminë tuaj
23 këtu.

24 DËSHMITARI: Okej.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Atëhere transkripti është në rregull.

4 Mund të vazhdoni znj. Alagendra.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Doja t'ju tregoja një dokument

6 tjetër që është SPOE00067084 deri në numrin 67089-ET. Dhe

7 faqja konkrete në anglisht është 67089. Edhe shqipja në të

8 njëjtin numër.

9 PY. Lexojeni tekstin që keni përpara dhe do t'ju bëjmë një
10 pyetje ose pyetje lidhur me këtë.

11 PË. Po, e lexova.

12 PY. Në këtë deklaratë në 22 prill 2016, i ke thënë

13 Prokurorisë kështu se dy personat që dyshoja që ishin të

14 përfshirë në vrasjen e numrit 1 ishin numri 12 dhe 13, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Dyshimin e kishe sepse nuk kishin uniforma atë ditë,
17 kështu?

18 PË. Uniformë nuk kishin. Ata janë kanë, sipas mendimit tim,

19 në përcjelljen e terrenit. Numri 12 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 PY. Thjesht dua të di lidhur me këtë që ke thënë këtu. Pra,

22 dyshimin e bazoje në faktin se nuk kishte uniformë dhe u

23 largua nga Kosova, kështu?

24 PË. Jo.

25 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, shtrembëruat përgjigjen. Nuk

1 përmendët faktin që ai tha që ata po vëzhgonin terrenin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Këtu i thoni Prokurores, se e
4 njihnit numrin 12, sepse [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 PË. Po.

7 PY. Kishin probleme me njeri-tjetrin me aq sa si ti?

8 PË. Ma herët jo. Po numri 12 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR] a nuk e di ku është.

10 [REDAKTUAR] Se ai e din rastin,

11 domethënë, kthjellët.

12 PY. Apo thoni që mund të kenë pasë ndonjë mëri personale
13 numri 1 me numrin 12?

14 PË. Jo, personale nuk kanë mujt me pasë. Ai ndoshta s'e ka
15 ditë kush mirret. Po ai a kanë në atë grupin e rrëmbimit ma
16 merr mendja. Ka marrë pjesë edhe ai, domethënë, ai është kanë
17 pa maska, ka shku me kontrollu terrenin ma herët për me i
18 informu tjerët. Ma merr mendja kjo ka ndodhë. Për atë është
19 shku ma herët ai aty.

20 PY. Kalojmë tek pika tjetër. A mund të na konfirmoni,
21 Dëshmitar, se nuk i është bërë autopsi numrit 1 menjëherë pas
22 vdekjes?

23 PË. Nuk është bërë.

24 PY. Numri 1 u varros menjëherë nga ora 4.00 e të njëjtës
25 ditë?

1 PË. Po.

2 PY. U varros -

3 PËRKTHYESJA: Më falni, nuk e kuptova pyetjen?

4 DËSHMITARI: Po, të njëjtën ditë është varros.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

6 PY. Rrjedhimisht nuk u bë as ekzumimi i trupit?

7 PË. Jo.

8 PY. Pra, nuk është bërë autopsi dhe nuk ka ndonjë raport
9 mjekoligjor, kështu?

10 PË. Jo.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Më duhet të kaloj në -- mund
12 të vazhdojmë në seancë publike.

13 PY. Ju kam pyetur për emblemat që kishin burrat e maskuar. Ju
14 pyeti si Mbrojtja e z. Thaçi dhe të tjerët dhe u përgjigje
15 kështu të enjten. The se nuk dije që dëshmitarë të tjerë në
16 fshat nuk i kishin parë emblemat e UÇK-së tek uniformat që
17 mbanin burrat e maskuar. Ju kujtohet ta keni thënë këtë?

18 PË. Ka mundësi edhe një herë pyetjen?

19 PY. Po. Kur ju bënë pyetje lidhur me faktin a e dije ti që
20 dëshmitarë të tjerë në fshat nuk e kishin parë emblemen që
21 mbanin burrat e maskuar?

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Na jepni dhe citimin.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po. Është transkripti i 18
24 majit faqja 4323, rreshti 24 dhe faqja 4324, rreshti 4.

25 Rreshti 1 deri në 4 në faqen 4324.

1 PY. Atij i je përgjigjur dhe ke thënë që:

2 "Nuk e dija që dëshmitarë të tjerë në fshat paskan thënë
3 që nuk e kanë parë emblemat e UÇK-së".

4 A të kujtohet ta keni thënë këtë?

5 PË. Po. Sigurisht e kam thënë ndoshta dhe s'më kujtohet tani
6 më. Kam thënë, po a dish nuk më kujtohet, kohë e gjatë, ça
7 kanë folë dëshmitarët unë nuk muj me ditën.

8 PY. Dua t'ju tregoj një dokument SPOE00067242 deri në 243,
9 67243. Ndërsa shqipja është SPOE00067240 deri në 67241.

10 PY. Të shohim pyetjen. Pyetjen që ju kanë bërë:

11 "Kush ishin ushtarët me uniforma të zeza?"

12 Dhe përgjigja është, thuhet:

13 "Ushtarët i thanë numrit 2 se ishin nga UÇK-ja. Nuk pashë
14 asnjë shenjë në uniformat e tyre".

15 A e shihni? Pra, ku thuhet:

16 "Ushtarët i thanë numrit 2 se ishin të UÇK-së. Nuk kanë
17 parë ndonjë emblemë në uniforma".

18 PË. E shoh ku është shkrun.

19 PY. Të kujtohet të ketë qenë numri 8 atje ditën e incidentit,
20 kështu, Dëshmitar?

21 PË. Ka qenë pas vrasjes, pas vrasjes ka qenë.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim një deklaratë tjetër.

23 DHK00190 deri në 193. Ndërsa shqipja është SPOE00067157 deri
24 në 67161, faqja konkrete është faqja me numër 67161.

25 PY. Kjo është deklaratë e numrit 6.

1 PË. Po.

2 PY. Kur e kanë pyetur çka po mbanin, çka kishin veshur personat
3 e maskuar, numri 6 konfirmon se ata, ato rrobat që kishin ata
4 s'kishin asnjë shenjë.

5 PË. Numrin 6 janë ardhë e kanë kërku ata atë ditë dhe numri 6
6 nuk i ka pa këta persona hiç. Ky ka qenë brenda [REDAKTUAR]
7 [REDAKTUAR] në A.

8 PY. Mund të ma përsërisni edhe njëherë përgjigjen, ju lutem?

9 PË. Numri 6 nuk i ka pa këta persona hiç, se ata janë ardhë
10 me kërku numrin 6, e nuk e kanë lënë me dalë prej A. Edhe ky
11 s'i ka pa uniformat hiç as asi, as kësi. Ky s'i ka pa hiç. Të
12 maskumit s'i ka pa ky.

13 PY. Numri 6 nuk ka thënë këtë. Nëse shkojmë më lart tek faqja
14 thotë:

15 "...kur dola" --

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faqja e parë e shqipes, ju
17 lutem. Është faqja me numër 67160, besoj. Përgjigja e fundit
18 tek kjo faqe.

19 PY. Nëse mund ta lexoni përgjigjen e fundit tek kjo faqe. E
20 lexove?

21 PË. Po.

22 PY. Pajtoheni me mua se ajo që ka thënë numër 6 është se ka
23 dalë nga pozicioni A, i pa këta personat. Një e pa edhe në sy,
24 më ka shikuar në sy dhe mund të vërente nën maskë që kishte
25 sytë e kaltër dhe ishte i gjatë. Kaq afër ishte ai me këtë.

1 PË. Kjo nuk është e vërtetë, këtë dëshmi ça e ka dhanë ai
2 këtu. Se ky s'i ka pa atë ditë këta persona hiç. Ky a dalë
3 shumë i mbrëmi. Mbasi a kry vrasja ku ka dalë nga A. Ka gënjy
4 këtu.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj se duhet të kalojmë në
6 seancë private për pyetjet e radhës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, të
8 kalojmë në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.
